

**Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR  
PROCEDURËN “SHËRBIM KONSULENCE”<sup>1</sup>**

**Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

---

<sup>1</sup> Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, autoriteti /enti kontraktor do t'i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

**NJOFTIME**

**NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I  
INFORMACIONIT**

*(Për t’u Plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)*

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor;**

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

**1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Institucion qendror

Institucioni i pavarur

Njësi e autoriteteve vendore

Të tjera

**1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për  
nevoja të veta

I deleguar

Organ Qendror blerës

Të tjera

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: \_\_\_\_\_

Tel/faks \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

### 1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

\_\_\_\_\_

### 1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: \_\_\_\_\_

### 1.7 Tipi i kontratës: \_\_\_\_\_

1.8 Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare) \_\_\_\_\_ :

### 1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër: \_\_\_\_\_

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### 1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

\_\_\_\_\_

### 1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

\_\_\_\_\_

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

# Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor )

## NJOFTIMI I KONTRATËS

### Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

#### 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri:	Bashkia e Tiranës
Adresa:	Sheshi Skënderbej,Nd. 2, Kodi postar 1001
Tel/Faks:	00 355 4 22 56 799
E-mail:	<a href="mailto:infrastruktura.arsimore@tirana.al">infrastruktura.arsimore@tirana.al</a>
Adresa e ueb-faqes:	<a href="http://www.tirana.al">www.tirana.al</a>
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	F.M <a href="mailto:infrastruktura.arsimore@tirana.al">infrastruktura.arsimore@tirana.al</a>

#### 1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	Institucioni i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësi e autoriteteve vendore	Të tjera
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

#### 1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta	Organ Qendror blerës
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I deleguar	Të tjera
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

#### 1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po  Jo

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

**1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:**

Po  Jo

**1.6 Kontratë e rezervuar:**

Po  Jo

**Seksioni 2: Objekti i Kontratës: Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF –92970-01-10-2024**

**2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) Projekte -22114311-5**

**2.3 Lloji i Kontratës: “Kontratë Konsulence”**

**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:**

Po  Jo

**2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:**

Me një Operator Ekonomik

Me disa Operatorë Ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po  Jo

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

**2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:**

**Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: \_\_\_\_ (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)**

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

--	--	--

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:** *(këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfutuese nga marrëveshja kuadër)*

---

**2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:**1,914,750** (një milion e nëntëqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë ) **lekë pa Tvsh**

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** \_\_\_\_\_

3. Burimi i financimit: vënë në dispozicion sipas VKB-ë Nr. 101, datë 15.09.2023 për disa ndryshime në vendimin nr.126, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023, të ndryshuar”,konfirmuar nga Perfekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot 1304/1, datë 25.09.2023.

4. Kodi Output: 2101001

5. Tipi:

Investime  Kodi: \_\_\_\_\_ Vlera: \_\_\_\_\_

Shërbime  Kodi: 230 Vlera: \_\_\_\_\_

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**

Kohëzgjatja **6 (gjashtë) muaj**

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

Kohëzgjatja në muaj: \_\_\_\_ ose ditë: \_\_\_\_ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)

Ose fillon më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ (d/m/v)

mbaron më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ (d/m/v)

**2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:**

---

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### Territori i Bashkisë Tiranë

#### 2.13 Ndarja në Lote:

**Po**  **Jo**

*Nëse po,*

#### 2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

##### 2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

- një Lot,
- disa Lote,
- të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

##### 2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi \_\_\_\_\_

##### 2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

---

---

---

---

##### 2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

**Po**  **Jo**

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

---

---

---

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 2.15 Pranoen variantet:

Po  Jo

#### 2.15.1 Pranoet nënkontraktimi:

Po  Jo

#### Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

*(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)*

---

#### 2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po  Jo

**Shënime të tjera** *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

---

---

---

### 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po  Jo

#### Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që nuk lejohet mbështetja:

---

## **Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5.



## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **38,295** (tridhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë).

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 \_\_\_\_\_ (shuma,monedha)

Loti 2 \_\_\_\_\_ (shuma monedha)

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor Kodi Institucionit: 2101001 dhe Llogaria ekonomike: 4662102

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

**3.2** Periudha e vlefshmërisë së ofertës: **150 (njqind e pesedhjetë)ditë.**

### **Seksioni 4: Procedura**

#### **4.1 Lloji i procedurës: Shërbim Konsulence**

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore:

#### **Faza 1 – Shprehja e interesit dhe Parakualifikimi (lista e shkurtër):**

Kandidatët do të dorëzojnë kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit. Autoriteti/Enti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim.

Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përsihen në një listë të shkurtër.

**Faza 2 – Paraqitja e propozimeve:** Autoriteti/Enti Kontraktor dërgon një ftesë për të dorëzuar propozime, kandidatëve që janë kualifikuar në Fazën 1 (Ofertuesit e përzgjedhur në listën e shkurtër).

Propozimet përfundimtare të kualifikuara shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kriterëve përkatëse nga Autoriteti/Enti Kontraktor. Ky i fundit ia jep kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur propozimin më të mirë të vlerësuar.

#### **4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:**

Po

Jo

Nëse Po, numri i referencës është \_\_\_\_\_

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 4.3 Procedurë e rishpallur:

Po  Jo

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit \_\_\_\_\_

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit \_\_\_\_\_

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit \_\_\_\_\_ (shuma , monedha)

### 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto:**

Çmimi **20 pikë**

**dhe**

Propozimi teknik **80 pikë**

#### **Kriteret e Vleresimit teknik**

#### **Pikët**

- |  |          |
|--|----------|
| (i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit  | [0-10 ]  |
| (ii) Metodologjia e Propozuar<br>(Përfaqsjë teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative) | [20-30 ] |
| (iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar   | [20-50 ] |
| (iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet)   | [10]     |

### 4.5 Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **23/01/2024** (d/m/v) ora **11:00**

Vendi: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

**Informacioni mbi kërkesat e paraqitura në mënyrë elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesa, në bazë të kërkesës së tyre.**

### 4.6 Gjuha (ët) për hartimin e propozimit dhe kërkesës për pjesëmarrje:

Shqip  Anglisht

### Seksioni 5: Informacione shtesë:

**5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):**

**Po**  **Jo**

*Nëse po*

**Monedha** \_\_\_\_\_ **Çmimi** \_\_\_\_\_

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)**

---

---

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softëerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softwerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 10.01.2024

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

*[Për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit]*

### FTESË PËR PROPOZIM

(shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor) fton për paraqitjen e propozimeve në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

.....  
.....  
.....  
.....

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve të kërkuara:

**Vendi i kryerjes së shërbimit:** (jepni një përshkrim të shkurtër) \_\_\_\_\_

**Kohëzgjatja e shërbimit:** \_\_\_\_\_

**Propozimi duhet të paraqitet në:** \_\_\_\_\_

**Afati i fundit për pranimin e propozimeve:**

.....  
[Përcaktoni datën dhe orën]

**Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese** \_\_\_\_\_

**Forma e komunikimit:**

Forma shkresore

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.)

## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### **NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri Bashkia e Tiranë

Adresa Sheshi Skënderbej,Nd. 2, Kodi postar 1001

Tel/Faks 00 355 4 22 56 799

E-mail [infrastruktura.arsim@tirana.al](mailto:infrastruktura.arsim@tirana.al)

Ueb-faqe [www.tirana.al](http://www.tirana.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: Shërbim Konsulence**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF –92970-01-10-2024**

**4. Objekti i kontratës : Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

**5. Fondi limit: 1,914,750** (një milion e nëntëqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë )Lekë pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj**

**7. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje: : 23/01/2024 (d/m/v) ora 11:00**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

### PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbime Konsulence :		
Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____		
Numri i kontratës	Titulli i kontratës	Përshkrimi i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

# Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor )

## NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

### 1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Faks \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Ueb-faqe \_\_\_\_\_

### 2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_

3. Lloji i procedurës së prokurimit: \_\_\_\_\_

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: \_\_\_\_\_

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: \_\_\_\_\_

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: \_\_\_\_\_

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): \_\_\_\_\_

8. Fondi limit : \_\_\_\_\_

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

10. Nëse shtyhet afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, të shënohet afati i ri i përcaktuar: \_\_\_\_\_

### Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

# Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

*(Për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

## **NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

### **1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Faks \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Ueb-faqe \_\_\_\_\_

### **2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_

**3. Lloji i procedurës së prokurimit:** \_\_\_\_\_

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër:**\_\_\_\_\_

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:**\_\_\_\_\_

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :**\_\_\_\_\_

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**\_\_\_\_\_

**8. Fondi limit:** \_\_\_\_\_

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:**



## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): \_\_\_\_\_

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: \_\_\_\_\_

Dhe afati i ri (nëse është rasti): \_\_\_\_\_

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri \_\_\_\_\_

NIPT: \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Kontaktet \_\_\_\_\_

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : \_\_\_\_\_

16. Burimi i financimit: \_\_\_\_\_

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor \_\_\_\_\_

---

## DOKUMENTAT E TENDERIT

### Përmbajtja:

#### **Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontratës.

#### **Seksioni II: Shtojcat**

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, termat e referencës, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

#### **Seksioni III. Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

#### **Seksioni IV: Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

## A. TË PËRGJITHSHME

- 1. Objekti i prokurimit**
  1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.
  2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).
  
- 2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm**
  - a) Operator Ekonomik është çdo person fizik ose juridik ose ent publik apo grup personash/entesh, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

- 1.1.të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;
    - 1.2.BOE i bashkëlidh Propozimit të tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.
  
  - b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Propozimit.
- 
- 3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit**

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

### 4. Ndryshimi i

#### Dokumenteve të Tenderit

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sic është bërë publikimi i Dokumentave të Tenderit.
3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

	<b>B. PËRGATITJA E KËRKESAVE PËSËMARRJE/PROPOZIMEVE</b>
<b>1. Shpenzimet e ofertimit</b>	Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen e paraqitjen e kërkesës/ propozimit të tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi i rezultati i procedurës.
<b>2. Gjuha e Ofertës</b>	Kërkesa/Propozimi, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Kërkesës/Propozimi mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.
<b>3. Dokumentet përbërëse të Kërkesës/Propozimit</b>	Kërkesa/Propozimi do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 4. Formularët e tenderit

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Kërkesës/Propozimit në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës/propozimit duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës/propozimit duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës/propozimit, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/propozim duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

### 5. Ofertat Alternative

Përveç nëse përkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

### 6. Çmimet

1. Çmimet e propozuara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Propozimit Ekonomik do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Propozimit Ekonomik bashkangjitur me këto DT.

3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Propozimit Ekonomik, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimet pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

### 7. Monedhat

Monedha (at) e propozimeve dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

specifikohet në njoftimin e kontratës.

### 8. **Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik**

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

### 9. **Periudha e vlefshmërisë së Ofertës**

1. Propozimi do të jetë i vlefshëm për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Propozimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor. Propozimi për një periudhë më të shkurtër nuk është i vlefshëm dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme:

a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor

b) Garanci bankare

c) Garanci sigurimi

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Propozimit.

3. Periudha e vlefshmërisë së Propozimit fillon nga momenti i hapjes së propozimeve. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Propozimit njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Propozimi nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Propozimit, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Propozimin.

Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së propozimit, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk

konfiskohet.

**10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet kërkesën për pjesëmarrje/propozimin sipas formularëve standard në këtë DT. Kërkesa/Propozimi nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

## C. PARAQITJA E KËRKESAVE/PROPOZIMEVE

**11. Faza (Parakualifikimi) Lista e shkurtër**

11.1 Paraqitja e kërkesave për pjesëmarrje duhet të bëhet brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Njoftimin e Kontratës.

Kërkesat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i kthehen Kandidatit të pahapura.

11.2 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë kërkesën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.3 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kërkesën origjinale dhe dokumentacionin përkatës të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Kandidatit dhe të shënuar: "Kërkesë për parakualifikimin për kryerjen e Shërbimeve; Njoftimi Nr. \_\_\_.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ----- d/m/v, në orën-----”** .

**12. Faza II Dorëzimi dhe vlerësimi i propozimeve**

12.1 Propozimet do të dorëzohen vetëm nga kandidatët që kanë marrë nje ftesë për propozim nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

**12.2 Propozimi duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

Propozimi përbëhet nga propozimi teknik dhe propozimi ekonomik.

**Propozimi teknik përfshin:**

a) Përshkrim të detajuar të Shërbimeve të propozuara dhe metodologjinë e tyre, që përmbajnë gjithë informacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit, dhe që është i mjaftueshëm për Autoritetin/Entin Kontraktor, për të përcaktuar nëse Shërbimet e propozuara plotësojnë kërkesat e specifikuar në Termat e Referencës;

b) Listën dhe Curriculum Vitae të Personelit Kryesor;

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

- c) Grafikon e Zbatimit;
- d) Propozimin alternativ teknik, nëse lejohet;  
(*çdo dokument tjetër të përcaktuar nga Autoriteti/enti kontraktor*).

### **Propozimi ekonomik:**

Formatin e Strukturës së Çmimit

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një propozim.

12.3 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

12.4 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin propozimin origjinal, i cili përbëhet nga zarfi i propozimit teknik dhe zarfi i propozimit ekonomik, të cilët identifikohen qartë duke bërë shënimet përkatëse.

Propozimi duhet të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Propozim për shërbime konsulence \_\_\_\_\_; Njoftimi Nr. \_\_\_

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ----- d/m/v, në orën-----” .**

### **13. Perlllogaritja e propozimit ekonomik**

Të gjitha çmimet e propozuara duhet të jenë fikse dhe jo objekt rishikimi. Kandidati duhet të dorëzojë:

- Tarifa për njësinë e kohës për çdo person;
  - Përmbledhje të kostove direkte dhe indirekte dhe shpenzimeve, duke përfshirë taksat, tarifatat, tarifatat e liçensave, siguracionin dhe kosto të tjera të lidhura me kryerjen e Shërbimeve;
  - Çmimin total të propozimit pa TVSH; dhe vlerën e TVSH, nëse është e aplikueshme.
- (*ndonjë informacion tjetër të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*).

### **14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë kërkesën/propozimin e tij.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin kërkesën/ propozimet e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për



paraqitjen e tyre. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e kërkesave/propozimeve. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM KËRKESE/ PROPOZIMI" ose "TËRHEQJE KËRKESE/PROPOZIMI".

3. Asnjë kërkesë/propozim nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

### D. SHQYRTIMI I KËRKESAVE/PROPOZIMEVE

**15. Konfidencialiteti** Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

**16. Përgjegjshmëria e kërkesave/propozimeve** 1. Një kërkesë/propozim e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "Devijim" është një shmangia nga kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "Rezervim" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "Mospranim" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një kërkesë/propozim nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

### E. VLERËSIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE

### F. VLERËSIMI I PROPOZIMEVE

**18. Vlerësimi i propozimeve teknike**

Autoriteti/Enti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e Referencës, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti/Enti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse Dokumentat e Tenderit parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.

**19. Kriteret e vlerësimit** Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

<b>Kriteret e Vlerësimit</b>	<b>Pikët</b>
<b>(i) Përvoja per Punë të Ngjashme të Konsulentit</b>	<b>[0-10]</b>
<b>Nënkriteret</b>	
<b>i/a Përvoja për punë të ngjashme</b>	<b>40-80%</b>
Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.	
<b>i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë</b>	<b>10-20%</b>
Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.	
Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.	
<b>(ii) Metodologjia e Propozuar</b>	<b>[20-30]</b>
<b>Nënkriteret</b>	
ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia	[20-30%]
ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	[30-40%]
ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]

**ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia:** Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqshen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përfaqshen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përfaqshen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikdhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

përfaqshjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

**ii/c. Organizimi dhe Stafit:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

### (iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- |                                    |           |
|------------------------------------|-----------|
| a- Kualifikim i përgjithshëm       | [5-20%]   |
| b. Eksperienca në fushën përkatëse | [30-80 %] |

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

### (iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t’i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

**Total (Propozimi Teknik) 100%**

**Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.**

## 20. Hapja e propozimeve ekonomike

Pas përfundimit të vlerësimit të propozimeve teknike, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve, nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim, dhe nuk vijon me hapjen e propozimeve të tyre ekonomike.

Në përfundim të afatit të ankimit Autoriteti/Enti Kontraktor i dërgon njoftimin për ditën dhe orën e hapjes së propozimeve ekonomike të gjithë kandidatëve, propozimet ekonomike të të cilëve do të hapen.

Në datën dhe orën e përcaktuar, Autoriteti/Enti Kontraktor hap propozimet ekonomike. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e propozimeve. Zarfë ku shkruhet “Propozimi Ekonomik” për secilin propozim që nuk është refuzuar më parë, do të hapet dhe informacioni i mëposhtëm do të shpallet e regjistrohët: emri i Ofertuesit, rezultati i vlerësimit të propozimit teknik, Çmimi i propozuar, siç shprehet në propozimin ekonomik.

### 21. Vlerësimi i propozimeve ekonomike

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton nëse propozimet ekonomike janë të plota, korrigjon ndonjë gabim arithmetike dhe për qëllime krahasimi e vlerësimi, i konvertton të gjitha çmimet e propozimit në një monedhë të vetme. Autoriteti/Enti Kontraktor rendit dhe cakton një rezultat për çdo propozim ekonomik.

#### 2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

#### Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik:  $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$**

**Pesha për Propozimin Ekonomik:  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Operatori ekonomik që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociatën dhe lidhjen e kontratës.

### **22. Korrigjimi i gabimeve arithmetike**

Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon propozimet ekonomike të paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse propozimet rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

### **23. Krahasimi i propozimeve**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fillon bisedimet me fituesin për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t'i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur.

Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 24. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

## G. DHËNIA E KONTRATËS

### 25. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Propozimi i tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### 26. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## H. ANKESAT

### 27. Procedura e ankesës

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## I. ANULIMI I PROCEDURËS

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### **28. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## **SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

- Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje  
Shtojca 2: Ftesa për Propozim  
Shtojca 3: Formulari i Deklarimit të Propozimit  
Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik  
Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës  
Shtojca 6: Lista e Informacionit Konfidencial  
Shtojca 7: Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

- Shtojca 8: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 9: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
- Shtojca 11: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes se Ofertuesve
- Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

### Shtojca 1

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

## KËRKESË PËR PJESËMARRJE

---

(Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i)

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:



## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

### Shtojca 2

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor]

#### **FTESË PËR PROPOZIM**

*(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)*

[Data]

Për : *[Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]*

**Procedura e Prokurimit:** \_\_\_\_\_

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se *[emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur]*, pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e pare, jeni kualifikuar për në fazën e e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë \_\_\_\_\_ *(emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)*

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### Data, ora dhe adresa

Data: □□/□□/□□□□(d/m/v) ora □□:□□

Adresa: \_\_\_\_\_

**Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

**Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:**

Shqip

Anglisht

### **Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

#### FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

- (b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
- (d) Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontratës;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- e) Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### Shtojca 4

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

#### FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK

**Tarifat sipas Kategorisë së Punës :** (Nëntotali i detajuar)

**Pagesat Ditore:** (Nëntotali i detajuar)

**Kostot e Drejtpërdrejta:** (Nëntotali i detajuar)

**Shpenzimet e Rimbursueshme:** (Nëntotali i detajuar)

## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

**TOTALI**

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 5

[ Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]  
Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]  
Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]  
Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,  
Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### Shtojca 6

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula



# Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit<sup>2</sup>**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

---

<sup>2</sup> Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

### Shtojca 8

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### **Shtojca 9**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

**Afatet e ekzekutimit:**

6(gjashtë) muaj

### Shtojca 10

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

### DETYRË PROJEKTIMI

“RESTAURIMI I MUZEUT ETNOGRAFIK , TIRANË”

(Monument Kulture Kat. I-rë)

(GODINA ISH BIBLIOTEKA KOMBËTARE (Ish Sarajet Toptanët)

Bashkia e Tiranës, me fondit 2,297,700 lekë me tvsh kërkon të realizojë Studim Projektimin për objektin: “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”, Ky projekt do të kërkohet të synojë ngritjen e Muzeut Etnografik të Tiranës, “METi”, në godinën dhe hapësirën që sot njihet ndryshe me emrin “Sarajet e Toptansve”, i cili në listën zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), rezulton me emertimin “GODINA ISH BIBLIOTEKA KOMBËTARE (ish Sarajet Toptanët), Lagjia 28 NËNDORI, NR.7, RR. "ALQI KONDI", me kod (I-08) dhe është Monument Kulture i Kat. I-rë, shpallur me:

Vendim Nr.6, datë 15.01.1963, nga Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës

Vendim Nr. 1886, datë 10.06.1973, nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës

Për lehtësi më poshtë po i referohemi si “Ish Sarajet e Toptanasve”, si toponimi më i njohur në memorien kolektive qytetare.

Me vendimin Nr. 619, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rijetësimi i “Banesës së Toptanasve” Muzeu Etnografik i Tiranës”

### Ortofoto e Pozicionimit te Objektivit

#### 1. Të përgjithëshme

##### 1.1 Rëndësia e Stilit/ Historia dhe situata ekzistuese

Në kontekstin historic, qyteti I Tiranës, në lindjen dhe zhvillimin e tij, ashtu sic do qendër paraqet vecanti, të cilat pasqyrojnë karakteristikat dhe me gjere realizimet e qytetit shqipetar të shek. XV – XIX. Deri në cerekun e parë të shekullit të XIX qyteti shtrihej përmes bërthamës ku ndodheshin pazari dhe dy xhamitë e vjetra. Qyteti I Tiranës dukej I crregullt, I shtrirë dhe I fragmentuar për shkak të trashëgimisë feudale dhe të prapambetjes ekonomike

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

dhe kulturore. Në thelbin e vet qendra e banuar e Tiranës, gjithnjë duke pasur rol historic, krahasimisht me e larte e parapëlqyer si banim, është një shembull me vlera për kalimin shkallësor nga një qendër fshatare në atë qytetare, madje në rrethana të vencanta në shek. XX për të qenë dhe kryeqyteti I Shqipërisë.

Toptanët janë nga familjet e pakta të mëdha të Shqipërisë dhe njëkohësisht nga familjet më të shquara të Tiranës, ata I përkasin shtresës së lartë të shoqërisë shqiptare (bejlerëve). Toptanët kanë qënë rreth 15 familje, duke nënkuptuar prezencën e shumë shtëpive në pronësi të tyre, nga të cilat sot kanë mbetur vetem disa, një prej të cilave është dhe “Godina e Ish Bibliotekes Kombëtare (Ish sarajet e Toptansve), sipas regjistrimit kombëtar të pasurive kulturore.

### 1.2 Pozicionimi i sitit

Emri: Muzeu Etnografik I Tiranës.  
Koordinatat: 41° 19' 38" N 19° 49' 16" E  
Hyrja: Nëpërmjet rrugës “Abdi Toptani”

Sipërfaqe sheshi rreth: 1680 m<sup>2</sup>  
Sipërfaqe e ndërtesës ekzoistuese rreth: 1300 m<sup>2</sup>

(Shënim: të dhënat e mësipërme duhet të nxirren të sakta nga rilevimet faktike të objektit dhe truallit)

“Sarajet” ndodhen në rrugën “Abdi Toptani”, në një kontrast me pallatet shumëkatëshe aty pranë. Para disa vitesh ky vend ka funksionuar si bar-restorant por tashmë është i mbyllur dhe nuk lejohen vizitorë.

### 1.3 Specifikime të Godinës dhe Silit

Kjo banesë është një object përfaqësues I arkitekturës vernakulare të shek të 20, me element arkitektonikë autentikë, me shumë pak ndërhyrje gjatë kohës., ku për këtë arsye është shpallur Monument Kulture I kategorisë së I-rë nga Rektorati I Universitetit Shtetëror me vendimin nr. 6 datë 15.01.1963 dhe më vonë nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendimin nr 1886 datë 10.06.1973. Kjo e bën thelbësore rëndësinë e mbrojtjes, konservimit, restaurimit dhe rijetëzimit të objektit.

“Sarajet u ndërtuan rreth viteve 1833-1840 dhe janë një nga të paktat saraje feudalësh të ruajtura në Shqipëri. Kompleksi paraqet interes nga ana ndërtimore, si për kompozimin funksional dhe për trajtimin arkitektonik – dekorativ.

Në fazën e parë të ndërtimit të saj ka qenë me cardak e hajat në ballin kryesor. Shtëpia e zjarrit është bërthama e mjediseve përçark saj. Në katin e parë janë ambientet ndihmëse ndërsa në katin e dytë ambientet e ndenjes dhe anekset e shërbimit. Shkallët që lidhin ambientet janë një ramëshe druri.

Në fazën e dytë, në fillim të shekullit të XX, u bë një rikonstrukcion I mjediseve si dhe mbyllja e cardakut.

Në fillim të shekullit të XX, ka qenë dhe selia e legatës së SHBA.

Godinat (godina kryesore dhe godina ndihmëse) janë të zbukuruara me dekoracione të ndryshme. Ato përbëjnë një kompleks arkitektonik me mure, oborre, puse, rrugë, porta të mëdha, banesa dhe ambiente ndihmëse.

Banesa ka Brenda një “Hamamxhik” (hamam me dimensione të vogla).

Për analizën e gjendjes së konservimit të pasurisë kulturore, monument Kulture i kategorisë së I – rë, godina u inspektua duke marrë në shqyrtim të gjithë materialet teknike të disponueshme dhe natyrisht kqyrjes vizuale në vend.

#### 1.3.1 Historiku i përdorimit të godinës.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Nga shqyrtimi I materialit arkivor vërehet që ndër vite kjo strukturë është përdorur në periudha të ndryshme për funksione të ndryshme disa prej të cilave po I cilësojmë më poshtë në mënyrë të përgjithshme.

Shek. 18: Shtëpi e familjes Toptani

Shek.19: Pronë e Familjes Libohova

Vitet 1925-1928: Ambasadë e Shteteve të Bashkuara

Vitet 1928 -1939: Bibloteka Kombëtare gjatë mbretërimit të Mbretit Zogu – I-rë

Vitin 1945: Biblotekë, pronë shtetërore gjatë periudhës komuniste

Vitin 1963: Zyra të Insitutit të Monumenteve të Kulturës

Vitin 1973: Kategorizohet si monument kulture

Vitin 1990: Insituti i Gjeografisë së Akademisë së Shkencave (laboratory i restaurimeve)

Vitin 1990: I rikthehet si pronësi ish pronarëve.

Vitin 2013: Përdorur si Bar Restorant.

Vitin 2021: Pronësi e Bashkisë së Tiranës.

Në ditët e sotme duke vlerësuar dhe rëndësinë e sitit , hapësirat që ka kjo strukturë dhe përshtatjeve të realizuara në vite, vlerësojmë se duke qenë se objekti nuk funksionon më si banesë familjare, hapësira në fjalë të kthehet në muzeun Etnografik të Tiranës, kjo duke vlerësuar dhe pozicionin strategjik në qendër të Tiranës.

### 1.3.2 Tipologjia e ndertimit dhe hapësirat e brendshme

Banesa dy katëshe është e ndërtuar nga mjeshtrat dibranë. Ajo vendoset në një parcel të rrafshët me orientim nga jug-lindja, duke I drejtuar diellit pamjen kryesore. Ajo ndodhet në zemër të Tiranës dhe zonës arkeologjike A të saj. Brenda rrethimit aktualisht gjenden dy objekte, banesa kryesore 2 katëshe dhe nje godinë një kat në pjesën e pasme të oborrit.. për të arritur në banesë kalohet nga një portë e madhepërgjatë rrugës “Abdi Toptani”.

1 – Godina Kryesore

Kjo godinë ka një sipërfaqe rreth 1050 m<sup>2</sup>, e kompozuar ne dy kate.

2 – Godina ndihmëse

Kjo godinë ka një sipërfaqe rreth 250 m<sup>2</sup> e kompozuar në një kat.

3 – Hapësirat përreth godinave.

Hapësirat përreth dy godinave kanë një sipërfaqe të përgjithshme rreth 900 m<sup>2</sup>.

Guzhina është vendosur në katin përdhe, ngjitur me dhomën e ndërrimit.

Dhomat e ndenjes dhe të gjumit janë të pozicionuara në katin e parë.

Gjithashtu godina dispononte një “Hamam” në brendësi të saj.

Tualetet kryesisht ishin pozicionuar pranë dhomës së ndenjes ku ngroheshin me sistemin e avujve të guzhinës dhe murit të oxhakat kryesor.

Kjo godinë u ndërtua nga mjeshtra ustallarë të zonës së Dibrës.

### 1.3.4 Anjalizë e materialeve të përdorura në konstruksionin original të ndërtesës.

Nga materialet arkivorevërehet që ndërhyrjet restauruese të viteve 70-80 kanë qenë të thella edhe në konstruksion. Kjo ndërtesë në fillimet e saj është ndërtuar në katin e sipërm me mure qerpici dhe skelet druri ku shkarkonte dhe ngarkesa e catisëme konstruksion druri dhe në katin përdhe muraturë guri me gjerësi 80 cm. Qerpici lidhet me llac balte përzier me kashtë.

Themelet ndërtohen me gurë lumi e lidhen me llac balte, ngrihen rreth 30-40 cm nga niveli I tokës dhe mbi to vendoset brez druri dhe muret. Catia ka konstruksion te dendur druri me lartësi kulmi mbi 4 m dhe te mbuluar me tjegulla vendi.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Nderkati është kryesisht konstruksion druri me dysheme – tavan derrase, ku në pjesën me të madhe tavanet janë të dekoruar me dru apo structure allcice mbështetur në tavan me listela derrase të mberthyer me tako druri në strukturën e catise.

Në mënyrë të përbledhur materialet origjinale të konstruksionit të ndërtesës mbeten:

Themele të vazhduara gur lumi dhe lidhës me llac balte

Fasada gur gelqeror I punuar për qoshet dekorative, catmja e përbere nga derrasa dhe koloncina e trare druri horizontale, mure qerpici me elemente diagonal në katin e parë

Dyer dhe dritare druri

Struktura vertikale, muratura e brendshme mur guri, mure qerpici dhe mikes me qerpic dhe elemente diagonal druri, catmaja e përbere nga derrasa dhe koloncina me trare druri, horizontale, vertikale dhe diagonal.

Konstruksion I catise dhe nderkatet me trare druri dysheme derrase, tjegulla vendi për mbulim Kati përde, pllaka guri në disa ambiente të shtruara dhe dysheme derrase

Lidhësi me përberje balte, gelqere, kashtë dhe rere.

### 1.3.5 Gjendja ekzistuese

Aktualisht nga vezhgimi vizual në objekt vërehet që në katin përde kemi përgjithsisht strukturë me muraturë guri, muraturë e qerpicit dhe catmase.

Ndërhyrjet ndër vite dhe pse janë munduar të respektojnë strukturën ekzistuese të ndërtesës perseri kanë bërë ndryshime të konstruksionit, si eliminimi apo shtimi I disa mureve ndarese, I cili vetëm pas zhveshjeve të suvave mund të gjykohej për shkallën e degradimit dhe mënyrën e konservimit të tyre. Këto ndërhyrje kanë bërë ndryshime dhe në skemën funksionale të qarkullimit nëpërmjet ndryshimit të pozicionimit të shkalleve. Në një veshtrim të përgjithshëm objekti nuk paraqet dëm thelbësorë të vetë konstruksionit, por ka një mikso strukturash mbajtëse që kanë një reagim të ndryshëm në nivel sigurie. Dëmtimet më të mëdha I perkasin sipërfaqeve në fasadë edhe në dekor. Ka dëmtime të mureve të qerpicit të dukshme në fasadë në pjesën jugore. Ka dëmtime të rifiniturave tavaneve dhe dyshemeve. Duhet theksuar se deri më vitin 2019 ka lënë disa gjurmë dëmtimesh në muraturë por kryesisht me rënie të suvave apo çarje të tyre. Gjithsesi një vlerësim më I thelluar duhet të realizohet.

Aktualisht sistemi elektrik dhe hidraulik është I gjithi për tu ritrajtuar, kjo në funksion dhe të objektit pasi është I gjithi jashtë funksionit. Më poshtë japim në mënyrë më të detajuar problematikat sipas zonave lokale:

Në katin përde të banesës konstatohet tavan druri I thjeshtë me cibuke me dëmtime të elementeve dyer dritare të brendshme dhe dollape muri prej druri gjithashtu të demtuara. Dera kryesore e hyrjes për në objekt është dru I dekoruar, dyshemeja me pllakë granili të kuqerremta të bordururara me pllakë të dekoruar paraqet dëmtime të pllakave deri në thyerje apo fugat të demtuara.

Suvaja në pjesë të konsiderueshme, paraqet dëmtime dhe lageshtirë të dukshme në faqet që dalin jashtë fasadës, ku edhe në fasadë degradimi është I dukshëm për shkak të mungesës dhe të ullukeve të shkarkimit të ujërave të shiut.

Elementet drusorë në përgjithësi paraqiten të demtuar

Vihet re shtrimi me pllakë I një kohe të mëvonshme, të llojit gres porcelanat dhe tavane gipsi me trare dekorative druri, për shkak të përdorimit të strukturës në periudhë të ndryshme kohore. Një ndër ambientet e katit përde është veshur me pllakë majolike pasi është përdorur për kuzhinë bar restoranti.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Konstruksioni I catise I cili eshte tejet I rendesishem paraqitet I demtuar dhe I degraduar edhe pse cedime ne sipërfaqen e pergjithshme nuk vihen re. Traret perberes te struktures se catise kane degradim te dukshem si rezultat I ekspozimit ndaj ujerave. Gjithsesi gjendja definitive e catise do te percaktohet pas hapjes se plote te saj.

Nderkatet paraqiten me problematika te qendrushmerise apo dhe kontrollin e tyre. Ka elemente te degraduar druri ne dysheme. Te gjithë traret e nderkateve duhet ti nenshtrohenkontrollit dhe nderhyrjeve restauruese teresore.

Strukturat ekzistuese te lehtesuara te cilat perfshijne te gjithë muraturen prej catmaje dhe qe jane ne fasade apo ndarese te mjediseve, per vete tekniken ndertimore duhet te rishikohen te kontrollohen dhe restaurohen. Ne to verehen shenja te degradimit prej lageshtise, presence vegjetacioni ne lartesi, renie suvaje dhe degradim te struktures mbajtese te drurit.

Rifiniturat ne pergjithesi kane degradime te dukshme

Elementet drusore dyer, dritare, dollape muri, sergjen, tavane te dekoruara ose jo, paraqesin degradime dhe kane nevojë per zevendesime ne fragmente te caktuara, por ne pergjithesi I gjithë materiali drusor mund te restaurohet me kujdes me qellim ruajtjen e elementeve origjinale.

Ka renie te xhamave, prishje te strukturave te vetratave apo dritareve, shenja lageshtie ne dyer e dritare, te cilat duhet ti nenshtrohen restaurimit.

2.Kërkesa projektimi të përgjithshme për reastaurimin e godinës dhe specifikime te projektit

### 2.1 Të përgjithshme

Bashkia e Tiranës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Promovues, kërkon të Krijojë Muzeun METi “Muzeun Etnografik të Tiranës”, duke synuar kështu krijimin e një Muzeu Historik Bashkëkohor, unik në llojin e tij për sa i përket trashëgimisë, subjektit, misionit, konceptit dhe arkitekturës.

Qëllimi kryesor është të përfitohen me realizimin e këtij projekti koncepte bashkëkohore dhe visionare për ndërhyrje të karakterit arkitekturor dhe restaurues për rehabilitimin dhe adaptimin e objektit ekzistues me status Monument Kulture i kategorisë së Parë, si dhe ndërhyrje rijetëzuese muzealizuese të propozuara për funksionin që pritet të ketë, dhe krijimin e një hapësire të re kulturore të shtuar në kryeqytet, i harmonizuar me zonë perreth.

Konceptet e ndërhyrjes duhet të bazohen në parime të cilat gjenerohen duke identifikuar karakteristikat arkitekturore, trashëgiminë, vlerat kulturore, historike dhe arkeologjike të zonës dhe përreth saj, si dhe nga eksperiencat me të mira kombetare dhe ndërkombëtare, duke prioritetizuar vlera në arkitekture, si dhe kualitete shumë të larta projektimi.

Principet kryesore të ndërhyrjes:

- Krijimi i një hapësire të re civile që të sigurojë interesin e njerëzve për trashëgiminë kulturore dhe pjesëmarrjen ndërvepruese të tyre.
- Transformim i Muzeut si pikë tërheqëse për aktivitete të ndryshme që mund të përfshihen në program (bar I hapur, hapësirë recreative, hapësirë pushimi, hapësira edukimi etj.
- Rehabilitim dhe projektim i ri i oborrit rreth muzeut.



## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

- Restaurimi i elementeve origjinale, si tavanet e drurit, dritaret e drurit, oxhaqeve, hamamit, catia etj.
- Rikonstruksioni i disa elementeve origjinale të cilët janë demoluar ose transformuar,
- Integrimin visual dhe Teknik të pajisjeve teknike të nevojshme për ndërhyrjet restauruese dhe transformuese të objektit.
- Punet restauruese dhe rikonstruktuese duhet të jenë një shembull i restaurimit profesional, I realizuar nga eksperte artizanë duke përdorur materiale tradicionale dhe teknikën tradicionale për këte kategori.
- Zevëndësimin e të gjithë elementeve jo origjinale me elementet origjinale element që bazuar në materialet arkivore grafike e fotografike ti rikthehen formës origjinale të objektit.

### 2.2 Funksonet e reja

Të merren në konsideratë minimalisht funksionet që do të zhvillohen në muzeun e ri, në objektin ekzistues, por jo të kufizuara vetëm në to:

#### Aktivitete kryesore

Aktivitetet në lidhje me ekspozita të përhershme dhe të përkohshme:

Hapësirë kushtuar Veprimtarive Kulturore

Hapësira e Qendrës së Dialogut

Hapësirë e dedikuar për ekspozitën e përhershme

Hapësirë e dedikuar për ekspozitën e përkohshme

Hapësira për zhvillimin e prezantimeve institucionale dhe publike (auditori)

ëorkshop – Hapësirë Edukativ

#### Aktivitete mbështetëse

Zona e pritjes

Qendra e Informacionit/ Zona e Biletarisë

Hapësirë rekreative

Hapësirë leximi

Dyqani i Muzeut

Dyqan kafeje

Garderobë

Nyja sanitare

Hapësirë ndihmëse

Hapësira administrative | kabinetet dhe funksionet e tyre utilitare

Arkivi i përhershëm i koleksionit

Arkivi i përkohshëm

Hapsirë ruajtjeje

Hapësira e Kontrollit Teknik

Hapësira Teknike

### 2.3 Restaurimi

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Projekti i restaurimit të pjesës së jashtme të godinës duhet të sigurojë ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbane dhe mjedisore të qendrës historike të qytetit të Tiranës.

Fasada e objektit: Ndërhyrjet restauruese në fasadën e objektit, duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të nxjerrin në pah vlerat e tij në vëllim dhe në pamjen e jashtme. Analiza të kushteve ekzistuese, projektit të konsolidimit, restaurimit dhe propozimit për forma më interaktive të komunikimit (projeksione të animuara);

Pikturat murale (nuk ka), në interior edhe në fasadë;

Elementët e drurit, në interior edhe në fasadë;

Oborri dhe ambientet përreth

Oborri duhet të trajtohet në tërësi e elementëve të tij. Ekipi i projektimit duhet të marrë në konsideratë një koncept të ri për këtë fushë.

Rivitalizimi i oborrit dhe ambientit përreth, studimi i hapësirave dhe kapaciteteve të mundshme.

Propozim për krijimin e kapilarëve komunikues urban, midis Muzeut dhe hapësirës së këmbësorëve në jug, pedonale së Kalasë së Tiranës, në veri, si dhe bulevardit Jean D'Arc.

Të merret parasysh se e gjithë zona është në një zonë të mundshme arkeologjike.

Restaurimi i mureve perimetrale prej guri dhe qerpici; Restaurimi i shtrimit me kalldrëm;

Restaurimi i portës së hyrjes ose riprodhimi sipas origjinalit.

Strukturë për aksesin e personave me aftësi të kufizuara.

### 2.4 Dimensionet e reja falë teknologjive të reja

Muzeu tradicional i historisë grumbullon kryesisht artefakte, të cilat i tregohen publikut për të paraqitur episode të ndryshme të historisë. Muzetë bashkëkohorë mbështeten nga teknologjitë e reja për të ofruar informacion plotësuese për artefaktet duke u lejuar vizitorëve të eksperimentojnë në të njëjtën kohë lloje të tjera eksperiencash. Disa nga teknologjitë e reja që mund të përdoren në muzeun e ri janë:

- Realiteti i Shtuar (AR) dhe Realiteti Virtual (VR);

- Përvojë gjithëpërfshirëse;

- Pajisjet interaktive.

### 2.5 Linja të shumta interpretimi për grupe të ndryshme të synuara

Muzeu Etnografik duhet të tërheqë dhe të jetë në gjendje të komunikojë me një audiencë sa më të gjerë të mundshme. Kjo audiencë formohet nga individë që kanë formim kulturor shumë të ndryshëm, interesa të ndryshme dhe reagojnë nga lloje të ndryshme stimuluesh.

Audienca e mundshme mund të grupohet në disa grupe të synuara që ndajnë një interes të përbashkët. Për të arritur të gjitha këto grupe të ndryshme ekspozita nuk duhet të ketë vetëm një sistem interpretimi, por disa mekanizma të ndërthurura që nxisin vëmendjen, kuptimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme.

Një listë paraprake e grupeve të synuara janë:

1. Moshë: 1.a. Fëmijët / 1.b. Të rinjtë / 1.c. Të rriturit / 1.d. Të moshuarit

3. Grupe të veçanta: 3.a. Personat e verbër / 3.b. Personat me aftësi të kufizuara

## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 2.6 Koha e kaluar gjatë vizitës

Vizitorë të ndryshëm planifikojnë të kalojnë periudha të ndryshme kohore gjatë vizitës në muze në bazë të shumë faktorëve të tillë si interesi i tyre kulturor dhe sasia e kohës së lirë që kanë planifikuar të kalojnë në Tiranë. Ekspozita duhet t'u sigurojë të gjithëve një përvojë të pasur dhe interesante pavarësisht nga koha e kaluar në muze.

Si rrjedhim, ekspozitat duhet të planifikohen sipas dy kohëzgjatjeve të vizitës: vizitë e shpejtë (rreth 1 orë), vizitë e ngadaltë (rreth 2 orë ose më shumë).

### 2.7 Program Edukues i Integruar

Muzeu duhet të ketë hapësira të përhershme edukuese për të zhvilluar programe edukative.

Ato duhet të konceptohen si hapësira multifunkionale të pajisura me projektorë për materiale audio-vizuale dhe punishte për punime të kryera me dorë. Pavarësisht nga niveli i njohurive të secilit grup, programi edukativ duhet të jetë një vend reflektimi, takimi dhe debati.

Muzeu Etnografik duhet të bëhet një qendër kulturore dhe qendër takimesh për Tiranën.

## 3. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventive

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar, si dhe të gjithë kërkesave të kategorisë së Monemunteve të Kulturës, dhe kërkesave të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur në Manualin e çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe Manualin Teknik të Çmimeve VKM nr. 627, datë 15.09.2015, si dhe të gjithë analizat për këtë kategori punimesh të referuara dhe me objekte të ngjashme të këtij lloji. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manuale, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do të bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe eficientë e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/ Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

Të gjitha specifikimet dhe llogaritjet do të dërgohen gjithashtu për miratim pranë Insitutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

## 4. Realizimi i projektit

Projekti për objektin: “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tirane” duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, duhet të kalojë në këto faza:

### FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/ termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit. Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit. Ajo duhet të përfshijë një analizë të argumentuar të çështjeve/ kërkesave kryesore të trajtuara në detyrën e projektimit.

a. Kryerja një studimi gjithëpërfshirës, përfshirë rishikimin e raporteve të inspektimit dhe dokumenteve të tjera përkatëse për secilin objekt. Këto dokumente do të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

- (i) planet ekzistuese dhe propozimet e ndërhyrjeve me karakter përforcues dhe konservues
  - (ii) studime të tjera teknike të disponueshme, sondazhe dhe dokumentacion të punimeve të kaluara në sit;
  - (iii) konventat ndërkombëtare, kartat dhe modelet e praktikës më të mirë të ruajtjes në lidhje me detyrën në fjalë;
  - (iv) ligjet, rregulloret kombëtare dhe lokale që lidhen me standardet dhe rregullat e ruajtjes për pasuritë e trashëgimisë kulturore në Shqipëri;
- b. Të përshkruajë metodologjinë për detyrën, duke përfshirë: fushën e studimeve shtesë që do të bëhen dhe sondazhe përpara zhvillimit të masave konceptuale të ndërhyrjes; si dhe metodologjinë për prioritizimin e ndërhyrjeve si dhe listën e ndërhyrjeve të nevojshme, kostot, metodologjinë dhe caktimin e prioritetëve, identifikimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme për zbatim, ndikimin në vlerën e trashëgimisë dhe një ekzaminim fillestar të masave mbrojtëse që identifikojnë aspektet sociale, mjedisore dhe të qëndrueshmërisë, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.
- c. Konsulenti pritet të kryejë aktivitetet e mëposhtme duke përfshirë (por jo kufizuar në):
- (i) Në vlerësimin e sitit dhe identifikimin e të gjitha ndërhyrjeve të nevojshme për ruajtjen dhe konservimin e tij;
  - (ii) studim në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore të sitit dhe sondazheve
  - (iii) një studim mjedisor;
  - (iv) siç do të përcaktohet nga Konsulenti, të kryejë sondazhe dhe vlerësime teknike të kërkuara për të identifikuar rreziqet që prekin sitin (për shembull, rrëshqitjet e tokës, humbje të materialeve, kushtet që shkaktojnë dëme strukturore progresive, etj) dhe vendet që mund të jenë më të rrezikuara. Studimet e kërkuara ka të ngjarë të përfshijnë: një studim topografik, studim gjeologjik, sondazhe gjeoteknike, një studim hidrologjik për sitin, analiza strukturore, si dhe modelim dhe analiza të strukturave dhe kushteve të tokës.
- Këto studime kanë për qëllim të: rikonfirmojnë fushat me përparësi më të lartë për ndërhyrje urgjente të identifikuar në studimet e mëparshme, si dhe të identifikojnë çdo fushë të re me përparësi shqetësimi për ndërhyrje në një plan afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë. Gjatë kryerjes së studimeve, Konsulenti duhet të marrë në konsideratë Ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore Materiale” dhe rregulloret që mbrojnë pasuritë kulturore. Sondazhet në sit mund të përfshijnë teste jo destruktive dhe teste minimale invazive të mostrave të materialit siç kërkohet për hartimin e ndërhyrjeve, pa shkaktuar dëm shtesë ose humbje materiali në sit. Nëse testimi shkatërrues strukturor dhe / ose sondazhet tokësore konsiderohen të nevojshme, ndikimet arkeologjike dhe trashëgimia duhet të vlerësohen paraprakisht për rishikim nga Autoriteti Kontraktor dhe palët e interesuara. Sondazhet destruktive duhet të aprovohen paraprakisht autoriteti kontraktor dhe organet kompetente.

### FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Bazuar në rezultatet e Analizes Paraprake, Konsulenti do të përgatisë një listë të ndërhyrjeve prioritare. Bazuar në këtë përparësi, projekt-ideja do të hartohet për ndërhyrjet me përparësi (lista e shkurtër) si pjesë e një plani veprimi urgjent. Kjo duhet të përfshijë fusha me përparësi të lartë për të zbatuar një program monitorimi afatgjatë.

Në zhvillimin e opsioneve të ndërhyrjes, duhet të merren parasysh këto: ruajtja e autencitetit të materialit dhe mbrojtja e pasurive kulturore, favorizimi i masave të ndërhyrjes që janë të kthyeshme, dhe ndikimet direkte dhe indirekte në trashëgiminë kulturore për masat e

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

propozuara. Për më tepër, duhet të paraqiten arsye për secilën ndërhyrje të propozuar së bashku me mënyrën se si projekti konsideron statusin, vlerat dhe gjendjen ekzistuese të pasurive të trashëgimisë kulturore të prekura.

Në përgatitjen e modeleve paraprake të konceptit për çdo ndërhyrje të zgjedhur me përparësi (listë e shkurtër), Konsulenti do të marrë në konsideratë pikat si më poshtë (por jo të kufizuar në) për të siguruar prezantimin teknik të përshtatshëm, siç janë:

Modelet paraprake arkitektonike / inxhinierike do të paraqiten me Skica dhe vizatime / vizualizim konceptual 3D, etj. Për propozime më të mira vizuale;

Planimetritë dhe prerjet gjatësore e tërthore teknike përkatëse / fasadat / detajet duhet të paraqiten në shkallë të përshtatshme vizatimi (psh. 1:50 - 1: 500, etj.). Për detaje të sakta shkallët nga 1: 1- deri në 1:25, etj. Duhet të përdoren për të siguruar lexueshmëri dhe saktësi teknike.

Preventivat Paraprakë;

Grafiku paraprak i punimeve;

Specifikimet paraprake teknike;

Raportet teknike paraprake;

Vlerësimet paraprake të ndikimit në trashëgimi;

Vlerësimet paraprake të ndikimit në mjedis dhe social;

Plani i Punës për punët që do të kryhen për të garantuar sigurinë në vend;

Udhëzim për zbatimin e punëve dhe planeve të mirëmbajtjes;

Sondazhet Teknike: Për të prodhuar projektin paraprak arkitektonik / inxhinierik të qëndrueshëm, do të zhvillohen (por jo vetëm): (i) sondazhe shtesë në terren, përfshirë studime topografike dhe arkitekturore në terren, vizatime të dimensionuara të ndërtesave / fasadat / elementet e tjera ku do të ndërhyhet.

Do të ketë diskutime dhe raportime interaktive të rregullta ndërmjet ekipit të Konsulentëve dhe Autoritetit Kontraktor, gjithashtu palë të interesuara (Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë, etj) dhe të siguroheni që ndërhyrjet e propozuara janë të realizueshme dhe në përputhje me fushën e konsulencës dhe janë zhvilluar duke marrë parasysh udhëzimet dhe rregulloret që veprojnë si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas këtyre konsultimeve, dokumentet paraprake të konceptit dhe raportimi do të azhurnohen për shqyrtimin përfundimtar deri në miratim.

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant- propozime, ku për secilin variant do të dorëzohen:

a. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, planvendosja, projekti paraprak Mnz, elektrik, hidro, etj.);

b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)

c. Preventiv paraprak;

Varianti që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,ëord etj.)

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemimit dhe i integritimit)

Dorëzimi: Konsulenti pritet të paraqesë dorëzimet e mëposhtme nën Detyrën 1:  
Projekt – Idenë dhe raportet përfundimtare: duke përfshirë të gjitha aspektet e listuara në paragrafët mësipër.

Prezantimi (në PP): Prezantimi i Projekt Idesë dhe Ndërhyrjeve të propozuara. Ky prezantim relatohet gjatë procesit të konsultimit dhe miratimeve të palëve të interesuara ose sa herë që vlerësohet e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor.

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt- idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë edhe:

Raport teknik;

Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe Manualin e cmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) ;

Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe Manualin e cmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.

Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;

Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;

Rilevimi;

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,ëord etj.)

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

Projekt ideja paraqitet për shqyrtim e miratim nga organi kolegjial “Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale” (KKTKM) pranë Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet sistemit E-leje për shërbimin “Ndërhyrje në Pasuri Kulturore”.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Miratimet dhe Lejet e Detyruara: Konsulenti përgatit dosjen e dokumenteve, përfshirë vlerësimin e ndikimit në trashëgiminë dhe Projektin e Detajuar të Zbatimit për lejet e detyruara për tu marrë nga organet vendore dhe të gjitha miratimet e tjera të kërkuara në proces (miratimi në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale). Pas miratimit në KKTKM, vijohet procedura e marrjes së lejes sipas legjislacionit të planifikimit të territorit. Miratimet e kërkuara do të identifikohen dhe kryhen nga Konsulenti, për të marrë miratimet dhe për të kompletuar Dokumentat për Tenderim.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë. Duhet të kthehet në konsideratë

FAZA V: Projekti zbatim: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Projekti i Detajuar i Zbatimit: Konsulenti do të përgatisë si vijon, por pa u kufizuar në: (i) vizatime të hollësishme të projektimit (arkitektonike, inxhinierike, elektrike, etj.) Planet / vizatimet / vizatimet 3D vizatime / detajet teknike / specifikimet e hartuara me saktësi duke përdorur standardet dhe praktikatat më të mira të projektimit të paraqitura në shkallën e duhur të vizatimit (p.sh. 1:50 - 1:500, etj.) Për detaje të sakta duhet të përdoren shkallët nga 1:1 deri në 1:25, etj. lexueshmëria dhe saktësia teknike; (ii) specifikimet teknike që mbulojnë të gjitha aspektet e projektit të detajuar të zbatimit; (iii) raportet teknike; (iv) preventivat; (v) Grafiku i Punimeve

Planet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis: Konsulenti duhet të përgatisë draftin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili do të jetë në përputhje me kërkesat legjislative kombëtare për marrjen e një leje mjedisore / autorizim. Draft raportet do të konsultohen nga palët e interesuara.

Dorëzohet: Konsulenti do të dorëzojë paketat e punëve bazuar në planin e planifikuar të zbatimit të aprovuar nga Autoriteti Kontraktor, dhe secila paketë e punimeve do të përfshijë për secilin projekt investimi: (i) dokumentacionin e detajuar të projektimit përfshirë vizatimet e planeve / prerjeve tërthore / pamje 3D / detaje teknike / specifikimet teknike bazuar në sondazhet teknike dhe duke përdorur standardet dhe praktikatat më të mira të projektimit; (ii) specifikimet teknike përfundimtare; (iii) raportet teknike përfundimtare; (iv) planet e menaxhimit dhe konservimit përfundimtar; (v) metodologjia përfundimtare për prioritizimin e ndërhyrjeve, listën përfundimtare të ndërhyrjeve me përparësi dhe planin e veprimit; (vi) preventivat përfundimtarë dhe (vii) vlerësimet përfundimtare të ndikimit mjedisor dhe social. Për detaje të mëtejshme referojuni tabelës së dorëzimeve.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Prezantimi (në PP): Prezantimi i Projektit të Detajuar të Zbatimit. Ky prezantim relatohet gjatë procesit të konsultimit dhe miratimeve të palëve të interesuara ose sa herë që vlerësohet e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit duhet të përmbajë:

Raportet teknike (konstruktiv, arkitektonik, topografik, gjeologjik, hidroteknik, elektrik, kondicionimi, efienca energjitike, kush/kuz,)

Planvendosjen e objektit

Planimetritë

Rilevimin topografik

Projektin arkitektonik

Projektin konstruktiv

Raport gjeologo-inxhinierik

Studimi sizmiologjik

Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin

Projekti hidroteknik

Projektin termoteknik/kondicionimi

Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;

Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;

Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit, përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;

Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

Preventivin e punimeve mbështetur në manualat teknike të çmimeve në fuqi;

Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;

Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;

Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakti i regjistrit tregtar.

Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dëg. , ëord, exel. Pas miratimit në KKTKM, vijohet procedura e marrjes së lejes sipas legjislacionit të planifikimit të territorit

### FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në Manualin e çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe eficienten e përdorimit të fondeve.



## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/ modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë.

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, si dhe bazuar në:

Projekt Zbatimi duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë e Kulturës për të vijuar sipas legjislacionit të planifikimit të Territorit.

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI
Hartim “Restaurimi i Muzeut Etnografik të Tiranës”		
Detyra 1: Analiza e Detyres se Projektimit dhe Projekt Ideja Paraprake		
Raporti i Studimit Paraprak; Plan i Konservimit ku përcaktohet e gjithë lista e nevojshme e ndërhyrjeve. Projekt Ideja dhe Raportet teknike paraprakë për takimin me përfaqësues të palëve të interesit	Studimi, rilevimi, mbledhja e dokumenteve; Dokumentimi grafik Pozicionin në hartë; Fotografi të gjëndjes ekzistuese të objektit; Rilevimi gjeometrik dhe arkitektonik i gjëndjes ekzistuese të objektit; Plan vendosje; Planet në çdo nivel; Prerje; Pamje; Elementë arkitektonike, etj. Analiza Historike Analiza e ndërhyrjeve në periudha kohore të ndryshme Analiza e strukturave Analiza e materialeve Analiza Statike- Strukturale Diagnostifikimi i gjendjes së objektit, degradimi i materaleve, degradimi i elementëve të structures studim në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore të sitit dhe vëzhgimit arkeologjik; studim mjedisor; studim topografik, studim gjeologjik, analiza strukturore, si dhe modelim dhe analiza të zgjedhura të strukturave dhe kushteve të tokës. Raporti Studimit Gjeologjik Raporti i Studimit Sizmik të zonës Raporti i Analizës strukturore të	5 kopje të raportit të printuar në formatin A4; materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A1 për planin e përgjithshëm. Një kopje elektronike në CD me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo document tjetër në format CAD, Excel, Word, PDF, etj.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik,Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI
	<p>objektit dhe analiza e materialeve.                      Raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor                      Lista e Ndërhyrjeve Prioritare                      Projekt Ide Arkitektonik dhe Restaurimi të sitit së bashku me Raportin Paraprak Arkitektonik                      Projekt idetë ndërhyrjeve strukturore, projekti konstruktiv së bashku e Raportin Paraprak Konstruktiv                      Përgatitja e Preventivave Paraprak për çdo nderhyrje që propozohet në listën prioritare                      Prezantimi PP i cili do të prezantohet nga Konsulenti gjatë takimit me palët e interest.</p>	
<b>Projekt Ideja Perfundimtare</b>		
<p>Projekt ideja perfundimtare dhe raportet perfundimtare teknike.</p>	<p>Raport teknik;                      Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;                      Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.                      Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.                      Specifikimet teknike për</p>	<p>5 kopje të raportit të printuar në formatin A4; materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A1 për planin e përgjithshëm.                      Një kopje elektronike në CD me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo document tjetër në format CAD, Excel, Eörd, PDF, etj.</p>

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI
	<p>zërat e punimeve, që do të kryhen; Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës; Rilevimi;</p>	
<b>Projekti i Detajuar i Zbatimit</b>		
<p>Projekti i Detajuar i Zbatimit dhe Raportet Teknik Prezantim PP</p>	<p>Projekti i Detajuar Arkitektonik dhe i Restaurimit, Raporti Arkitektonik dhe Restaurues Analiza e gjendjes ekzistuese. Analiza historike. Rilevimi arkitektonik Rilevimi gjeometrik dhe fotografik-identifikimi i tipologjisë së ndërtimit, teknikat. Dokumentimi dhe rilevimi i gjendjes aktuale të elementëve artistiko-arkitektonike Ndërhryjet restauruese dhe metodologjia e ndërhryjeve: konsolidim, përforcime, pastrime, shitesa. Planimetria e çdo niveli, (dimensionimi); Prerje teknike; Pamje teknike (specifikimi i materialeve të rifiniturave të ndryshme); Ndërhryjet restauruese në detajet artistiko-arkitektonike. Fotomontazh; Animacion. Projekti i Detajuar Konstruktiv, Raporti Konstruktiv - Analiza e gjendjes ekzistuese - Analiza strukturale e objekteve që i nënshtrohen restaurimit; Në varësi të nivelit dhe llojit të ndërhryjes përforcuese duhen: - Planet; - Prerjet;</p>	<p>5 kopje të raporteve të printuar në formatin A4; materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A1 për planin e përgjithshëm. Një kopje elektronike në CD me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo document tjetër në format CAD, Excel, Ëord, PDF, etj.</p>

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Detaje konstruktive (analiza shpjeguese të ndërhyrjeve);</li> <li>- Llogaritje dhe skema të vendosjes;</li> </ul> <p>Projekti i Detajuar Elektrik, Raporti Elektrik</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planet e instalimeve elektrike;</li> <li>- Ndriçimi i jashtëm;</li> <li>- Ndriçimi i emergjencës;</li> </ul> <p>Projekti i Detajuar Hidroteknik, Raporti i Instalimeve Hidroteknike Plani i kullimit, grumbullimit dhe shpërndarjes së ujrave të shiut Preventivi i Projektit të Zbatimit Specifikime Teknike Grafiku i Punimeve</p>	
<b>Lejet e Nevojshme</b>		
Dosja e Projektit të Detajuar të Zbatimit duhet të përfshijë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë Lejet e nevojshme në organet lokale.	Konsulenti duhet të dorëzojë Dosjet e Projektit të Detajuar të Zbatimit.	Dosja e Projektit të Detajuar të Zbatimit duhet të dorëzohet në 5 kopje pranë Autoritetit Kontraktor
Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social	Konsulenti duhet të marrë miratimin paraprak të VNM-së pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 kopje të printuara dhe të firmosura, duke përfshirë licensat/certifikatat e nevojshme</li> <li>- Një kopje elektronike e raporteve në formatin .doc dhe PDF</li> </ul>
Miratimi i lejeve nga Institutet dhe organet	Miratimet dhe Lejet e Detyruara: Konsulenti përgatit dosjen e dokumenteve, përfshirë vlerësimin e ndikimit në trashëgiminë dhe	Format Elektronik

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI
kompetente	<p>Projektin e Detajuar të Zbatimit për lejet e detyruara për tu marrë nga organet vendore dhe të gjitha miratimet e tjera të kërkuara në proces (miratimi në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale). Miratimet e kërkuara do të identifikohen dhe kryhen nga Konsulenti, për të marrë miratimet dhe për të kompletuar Dokumentat për Tenderim.</p> <p>Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrisë të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë. Duhet të kihen në konsideratë</p>	
Perfundim		

### 5. Konsiderata të rëndësishme

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me:

Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;

Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”;

Konventat Ndërkombëtare të Restaurimit.

Për hartimin e projektit të këtyre aseteve, konsulenti duhet të përdori standardet më të mira ndërkombëtare për këto tip objektsh (KTP89, EUROKODE etj.).

Projektet elektrike duhet të respektojnë të gjitha konditat projektuese dhe standardet që janë sot në fuqi në Shqipëri (KTP – STASH) dhe për elementë speciale që nuk parashikohen në këto standarde duhet të referohemi Euronorms (EN), Eurostandarteve (EN, ED) dhe rekomandimeve të CEI, CENELC, DIN, VDI/VDE.

Gjatë gjithë fazave të projektimit, grupi i projektimit do të analizojë e të japë të dhëna të hollësishme për ecurinë duke u mbështetur e bashkëpunuar me Autoritetin Kontraktor.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjisllacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja për përcaktimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe kufizimet për financimin e veprës,

Kërkesa arkitektonike e konstruktive të objektit

Konsulentit i kërkohet të analizojë e çertifikojë të gjithë elementet arkitektonikë e konstruktivë, inxhinierike të kësaj zone ndërhyrjeje si: qëndrueshmëria, gjendja e konservimit, materialet, detajet, etj, dhe të propozojë një projekt për restaurimin dhe rikualifikimin e sitit të pasurisë kulturore.

Preventivi i projektit të zbatimit

Preventivin e zbatimit (bazuar në Manualin e cmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe VKM Nr.2, datë 8.5.2003. “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit “);

Analizën teknike të çmimeve për të gjitha zërat në preventiv bazuar në Vendim i KM Nr. 627, datë 15.7.2015. “Për miratimin e manualeve tekniketë çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, si dhe Manualin e cmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR)

Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar).

Specifikime Teknike

Kontraktori duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:

Përshkrimi i detajuar i zërit të punimeve;

Mënyra e vendosjes;

Cilësia e kërkuar;

Formatet e lejuara;

Ngjyra e rekomanduar;

Skica, vizatime ose foto.

I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht sipas kërkesave për pajisje me leje për ndërhyrje në Pasuri Kulturore, në bazë të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” si dhe leje ndërtimi të përcaktuara në bazë të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me VKM Nr. 271, datë 6.4.2016.

Gjuha specifike e kontratës

Gjuha në këtë kontratë pune do të jetë shqip.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 6. Rekomandime për projektuesin

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet objekti, sistemin ekzistues të largimit të ujërave, sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, distancat e lejuar si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.

#### Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

#### Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

#### Kërkesat për stafin

Konsulenti do të sigurojë një ekip me përvojë në projektim, që mbulon disiplinat e nevojshme për kryerjen e duhur të shërbimeve. Ekipi i projektimit duhet të ketë eksperiencë në: restaurim, projektimin e ndërtesave civile, në infrastrukturë; në mënyrë që të mbulojë çdo disiplinë të nevojshme për përgatitjen e këtij projekti.

Për shkak të natyrës së veçantë të shërbimeve, përfshirja e ekspertëve në mënyrë të përshtatshme të kualifikuar do të jetë një kërkesë thelbësore për marrjen e projektit optimal me kosto efektive si dhe sigurinë për investime të qëndrueshme.

Pjesë e grupit të projektimit duhet të jenë:

Projektues Konstruktor;

Projektues Restaurator; Sipas VKM Nr. 792 dt. 07.10.2020, i ndryshuar me VKM Nr. 329, dt. 02.06.2021

Projektues Arkitekt;

Projektues Instalator mekanik dhe elektrik;

Projektues Vepra Hidraulike;

Projektues Gjeodet;

Studiues Projektues Gjeologo – Inxhinierik – Hidrogjeologjik;

Studime të Sizmologjisë Inxhinierike;

Ekspert mjedisi;

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Ekspert për Mbrojtjen nga Zjarri;  
PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT

Konsulenti do të jetë përgjegjës për zbatimin në tërësi të detyrave të përcaktuara në dokumentin në fjalë. Për këtë qëllim, Konsulenti do të mbartë të gjitha shpenzimet që lidhen me punësimin dhe mobilizimin e ekipit të tij të ekspertëve. Kjo përfshin shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit.

Asnjë objekt nuk do të sigurohet nga Autoriteti Kontraktues.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për kostot e prodhimit, përkthimit, shtypjes dhe shpërndarjes së të gjithë materialeve informative, dokumenteve dhe raporteve të kërkuara për kryerjen e detyrës.

Konsulenti do të jetë i vetmi përgjegjës për përmbushjen në kohë dhe në mënyrë cilësore të të gjitha çështjeve të përmendura më lartë në këtë detyrë.

Gjithashtu duhet te kihet në konsideratë se:

Sipas Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”:

36. “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Në kuptim të këtij ligji, në bazë të intensitetit të ndërhyrjes në pasuritë kulturore, këto të fundit kategorizohen në:

a) “Monument kulture i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.

### Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (autoCad). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

### Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i aprovuar.

## Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT



## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit<sup>3</sup>.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

c. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.*

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit *si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- a. Sipas pikes 1 të shtojcës 11 (Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim).

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve pozitive të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (**2021,2022**) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të pakten në dy vite të njepasnjeshëm. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë

---

<sup>3</sup> Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

***Shënim:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**2.2.2.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021,2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, sipas kësteve, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

## **Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.**

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

### **2.3.1 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim ), ku të përfshihen kategorite:**

#### **2. PROJEKTUES ARKITEKT**

- b-2) Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulturi; objekte arsimore;
- c- Projektim interiere;

#### **3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

- a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

#### **4. PROJEKTUES INSTALATOR**

- a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;
- b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;
- c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;
- f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;
- j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.

#### **5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE**

- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

#### **8. PROJEKTUES GJEODET**

- a) Rilevime inxhinierike

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

### 9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

### 12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë License profesionale per nderhyrjet ne pasurite kulturore materiale (leshuar nga Keshilli Kombetar i Trashegimise Kulturore Materiale, rane Institutit Kombetar te Trashegimise Kulturore) ose Kontratë Shërbimi ose Marrëveshje Bashkëpunimi që disponojnë licensën e mësipërme ku të përfshihen kategoritë:**

#### ***Projektim: Arkitekture***

*P/A/5 – Konservim dhe restaurimi i arkitektures se tradites (Vernakulare)*

*Gjinite: 25 Arkitektura e tradites*

*P/A/7 - Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;*

#### ***Projektim: Vepra Arti***

*P/V/3 – Konservim dhe restaurim i veprave te artit ne dru*

*Tipologjite: 3206 – Zbukurime ne dru (tavane karakteristike, elemente dekorative me gdhendje ne dru pjese e gjinive te arkitektures se tradites*

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

**2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në Licensen e Shoqërisë stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:**

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqese:

**Kontratat individuale të punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .**

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë shtojcën 7 deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit *si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës;
- 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqese:

**Kontratat individuale të punes (të vlefshme), Diplomë, CV**

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

Dokumenta Standarde të Tenderit - Procedura Shërbim Konsulence

---

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë shtojcën 7 deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit *si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

**2.3.4.** Një listë të personelit kryesor dhe stafit mbështetës ku të specifikohen emrat dhe profili , që do të angazhohen në këtë objekt prokurimi.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **10 (dhjetë)** punonjës për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit *si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese Certifikatat të pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si me poshte:

## Studim Projektim “Restaurimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”.

